



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLICA OF KOSOVO	
QENDRA PER SHERBIM TE QYTETARIT CENTAR ZA USLUGU GRADANA	
Sh. U.	Nr. 23361
U.	Br.
Nr. i faq. 1	Data: 26/08
Br. str.	Datum: 2025
KAMENICE/A	

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Zyra e Kryetarit

Sh.02.Nr.312, datë: 25.08.2025

Në mbështetje të nenit 13, 17 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), Ligjit Nr.04/L-027 Për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, neni 5, paragrafi 5.1, shkronja d), neni 70, paragrafi 70.1 dhe neni 82 të Statutit Sh.02.Nr.20203 i dates 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, si dhe duke marrë parasysh rrezikun e shtuar nga zjarret gjatë periudhës së verës, Kryetari i Komunës nxjerr këtë:

URDHËRES

Për ndalimin e ndezjes së zjarreve në hapësira publike dhe private në territorin e Komunës së Kamenicës

1. Ndalohen rreptësisht ndezja e zjarreve dhe djegia e mbeturinave, barit të thatë ose materialeve të tjera në të gjitha hapësirat publike dhe private, përfshirë pyjet, kullosat, fushat, parqet dhe zonat e tjera të natyrës në territorin e Komunës së Kamenicës.
2. Qytetarët dhe vizitorët obligohen që gjatë qëndrimit në këto hapësira të tregojnë kujdes të shtuar për mjedisin, të mos përdorin mjete që mund të shkaktojnë zjarr dhe të njoftojnë menjëherë çdo rast zjarri ose rreziku të mundshëm tek Policia e Kosovës (192) ose numri emergjent (193).
3. Çdo shkelje e këtij urdhri do të trajtohet sipas ligjeve në fuqi, përfshirë procedurat kundërvajtëse dhe penale sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës, të cilat parashohin gjoba dhe burgim për personat që shkaktojnë zjarr.
4. Drejtoria për Shërbime Publike, Ambientin, Inspektoriati dhe Emergjenca, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës dhe Njësinë e Zjarrfikësve, janë të obliguar të zbatojnë këtë urdhër dhe të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për parandalimin dhe sanksionimin e shkelësve.
5. Zyra për Informim obligohet të informojë qytetarët lidhur me këtë urdhëresë, përmes mediave elektronike dhe kanaleve të tjera të komunikimit publik.
6. Ky urdhër hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe mbetet aktiv gjatë sezonit veror, kur rreziku nga zjarret është më i lartë. Pavarësisht këtij urdhri, zjarrvënja mbetet e ndaluar në çdo kohë, pasi përbën vepër penale sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

T'i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës për Informim;
- Drejtorisë për Shërbime Publike, Ambient, Inspektoriat dhe Emergjenca;
- Policisë së Kosovës; dhe
- Q.SH.Q – arkivit.

